



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER PERIAN B. BODINAKU
ADRESA Ç. TOPULLI
TEL: 674010104

KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT

Nr. repertori: 6562

Nr. koleksioni: 2923

Tirane më 02/04/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025052640272752048

*Ky material përbëhet nga 9 fletë



A2025062640272750048

AKT – THEMELIMI
I
SHOQATËS “FAMILJA ITALBA”

Sot, më datë 02/10/2025, para meje Noterë PERIAN B. BODINAKU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Ç. TOPULLI, u paraqiten personalisht, anëtarët themelues të Shoqatës “Familja Italba”,

THEMELUESIT: **Cristhian Armati**, atësia Emilio, amësia Maria Isabella, shtetas Shqiptar, lindur në ITALI, Itali (ITA) dhe banues në DURRËS, me adresë Taulantia 00690806; Nd. 13; H. 1; Durrës; Durrës; 2025; Durrës, lindur më 29/01/1985, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 154985 dhe nr. personal I53129002W, .

Marjush Çela, atësia Ilirjan, amësia Lindita, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rr.Abaz Çelkupa; Nd. 0000; H. 00; Ap. 000; Durrës; Durrës; 2004; Durrës, lindur më 25/09/1984, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033447732 dhe nr. personal I40925075A, .

Susanna Ciacci, atësia Renato, amësia Giovanna, shtetase Shqiptare, lindur në ITALI, Itali (ITA) dhe banuese në DURRËS, me adresë Egnatia 00690218; Nd. 125; H. 1; Durrës; Durrës; 2025; Durrës, lindur më 02/08/1957, gjendja civile “e divorcuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 289375 dhe nr. personal F78802002J, .

Elisabetta D'anella, atësia Pietro, amësia Enda, shtetase Shqiptare, lindur në ITALI, Itali (ITA) dhe banuese në TIRANË, me adresë Perlat Rexhepi; Nd. 8; H. 6; Ap. 25; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 20/10/1972, gjendja civile “e divorcuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 286784 dhe nr. personal H29020003N, .

Giuseppe Mazzei, atësia Vincenzo, amësia Carmela, shtetas Shqiptar, lindur në ITALI, Itali (ITA) dhe banues në DURRËS, me adresë Egnatia 00690218; Nd. 54; H. 1; Durrës; Durrës; 2025; Durrës, lindur më 07/01/1953, gjendja civile “i divorcuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 281726 dhe nr. personal F33107003H, .

Abramo Poggi, atësia Bruno, amësia Rosa Pia, shtetas Shqiptar, lindur në ITALI, Itali (ITA) dhe banues në DURRËS, me adresë Hani I Kthupit 00690312; Nd. 5; H. 1; Durrës; Durrës; 2003; Durrës, lindur më 27/07/1967, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 284980 dhe nr. personal G73727002H, .

Klaudian Salliu, atësia Ismail, amësia Aferdita, shtetas Shqiptar, lindur në Peshkopi, Dibër dhe banues në DURRËS, me adresë Kumini 00690444; Nd. 9; H. 5; Ap. 17; Durrës; Durrës; 2001; Durrës, lindur më 14/10/1985, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035984449 dhe nr. personal I51014051N, .

Michele Sassanelli, atësia Giacomo, amësia Santa, shtetas Shqiptar, lindur në ITALI, Itali (ITA) dhe banues në DURRËS, me adresë Edit Durham 00690216; Nd. 9; H. 1; Durrës; Durrës; 2004; Durrës, lindur më 30/08/1983, gjendja civile “i divorcuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 277501 dhe nr. personal I33830002A, .

Samuele Poggi, atësia Abramo, amësia Stefania, shtetas Shqiptar, lindur në ITALI, Itali (ITA) dhe banues në DURRËS, me adresë Taulantia 00690806; Nd. 33; H. 6; Durrës; Durrës; 2025; Durrës, lindur më 23/05/2001, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 291876 dhe nr. personal K13523005D. Të gjithë janë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, dhe bazuar në Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” dhe në Ligjin 80/2021 “Pregjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, dhe nenin 39 e vijues të Kodit Civil, kemi krijuar organizatën jofitimprurëse , Shoqatën “Familja Italba”



A2625652640172782048

Neni 1 Statusi ligjor i shoqatës

Shoqata "Familja Italba" është themeluar me vullnet të lirë nga një grup anëtarësh dhe është një shoqatë jofitimprurëse me anëtarësi

Ajo është një organizim joqeveritar, e pavarur nga partitë e organizatat politike dhe gëzon liri dhe autonomi të veprimit në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe Programin e Saj.

Neni 2 Emri i shoqatës

Shoqata quhet "Familja Italba" dhe vepron në përputhje me ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse".

Shoqata ka stemën (logon) dhe vulën e saj. Forma dhe përmbajtja e stemës (logos) dhe vulës së Shoqatës përcaktohen nga organet drejtuese të Shoqatës. Logo e shoqates do e jete: Flamuri italian trengjyrësh jeshil, i bardhë dhe i kuq me shqiponjë dykrenore në shiritin e kuq.

Neni 3 Fillimi i aktiviteteve, Vendodhja, Kohëzgjatja

Shoqata fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit në Regjistrin e organizatave jofitimprurëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Shoqata ka selinë qendrore në Durrës, në adresën: Rruga A.Goga, lagjja 11, ZK 8514, Pasuria I/X-ND1-3, Durres.

Shoqata do të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në vendin përkatës.

Ajo mund të themelojë degë të saj në çdo njësi tjetër administrativo-territoriale të Shqipërisë. Këto degë nuk janë persona juridike të veçantë, por pjesë e organizatës. Ajo ka të drejtë të themelojë degë të saj, filiale etj. jashtë territorit të Shqipërisë.

Shoqata do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë të pakufizuar.

Neni 4 Objekti i Aktiviteteve

Misioni dhe qëllimi i Shoqatës janë:

- të krijojë një komunitet solid me italianët në Shqipëri,
- të promovojë marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunuese midis italianëve që banojnë në Shqipëri dhe popullsisë vendase dhe institucioneve shqiptare.

Objekti i aktiviteteve të Shoqatës është:

-të ofrojë anëtarëve dhe familjeve të tyre informacionin dhe mbështetjen orientuese të nevojshme për të lehtësuar futjen dhe integrimin e tyre në realitetin shqiptar dhe për të trajtuar problemet që lidhen me jetën e përditshme.

-të mbajë marrëdhënie të vazhdueshme bashkëbisedimi dhe bashkëpunimi besnik e konstruktiv me institucionet italiane dhe shqiptare, vendore dhe kombëtare.

-të mbledh nevojat, çështjet kritike dhe propozimet nga anëtarët dhe vepron si zëdhënës i institucioneve italiane dhe shqiptare



A20025052640272752048

- organizon evente sociale, kulturore, sportive dhe argëtuese edhe në bashkëpunim me shoqatat dhe institucionet shqiptare.

- të promovojë, organizojë, kryejë dhe shpërndajë aktivitete kulturore, teatrale, muzikore, rekreative, kinematografike, sportive, argëtuese, vallëzuese dhe çdo veprimtari tjetër shprehëse artistike, si dhe shfaqje dhe koncerte për përhapjen dhe vlerësimin e artit dhe kulturës.

- të promovojë dhe organizojë konferenca, debate, skena, konferenca, konkurse, çmime, si dhe kurse rifreskuese dhe zhvillimi profesional në fushën artistike, kulturore, bujqësore dhe teknike profesionale.

- të promovojë, organizojë, kryejë dhe shpërndajë aktivitete kulturore që synojnë njohjen, përhapjen, promovimin dhe përdorimin e territorit në lidhje me qytetërimet italiane dhe shqiptare, veçanërisht në fushën rurale dhe artizanale, zhvillimin dhe vlerësimin e aktiviteteve prodhuese vendase, valorizimin, të produkteve tipike dhe aktiviteteve ushqimore dhe verës.

- të nxise, organizojë, kryejë, rrisë dhe përhap aktivitete studimore dhe kërkimore në lidhje me territorin në të gjitha aspektet e tij historike, sociale, njerëzore, prodhuese dhe etnografike.

- të promovojë, organizojë, zbatojë dhe mbështesë ngjarje dhe iniciativa, studime, kërkime dhe konferenca në lidhje me territorin në të gjitha aspektet e tij historike, sociale, njerëzore dhe produktive.

- të promovojë, organizojë, kryejë dhe mbështesë veprimtaritë e mirëqenies në fushën e të drejtave të njeriut, bashkëpunimit dhe zhvillimit ndërkombëtar, solidaritetit dhe vlerave të paqes, vëllazërisë midis popujve, mbrojtjes së trashëgimisë artistike, mjedisore dhe kulturore dhe promovimit të solidaritetit shoqëror.

Shoqata mund të marrë pjesë me anëtarët e saj, të kryejë ose të bashkohet në iniciativa të ngjashme të promovuara dhe të organizuara nga shoqata të tjera, organe publike, organizata.

Neni 5 Organet Drejtuese

Organet drejtuese të Shoqatës janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli Drejtues;
- c) Kryetari
- d) Nënkryetari;
- e) Zëvendës Nënkryetari
- f) Sekretari i Përgjithshëm
- g) Përgjegjësi i Financave;
- h) Këshilli i Ndërmjetësve

Të gjitha pozitat në organet e Shoqatës mbahen mbi baza nderi dhe nuk sjellin asnjë kompensim ose shpërblim, përveç rimbursimit të thjeshtë të shpenzimeve të bëra në interes të Shoqatës, përfshirë edhe për qëllimet e përfaqësimit të Shoqatës, të miratuara më parë nga Këshilli Drejtues.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve zgjedh ose shkarkon Këshillin Drejtues me votim të fshehtë.

Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë të drejtën e votës së barabartë në Asambleenë e Përgjithshme.

Veprimtaritë e përditshme dhe zbatimimi i programeve të vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës i shoqatës kryhen nga organi i lartë ekzekutiv.



A2025052640272752048

Rregullat e veprimtarisë së organit të lartë ekzekutiv përcaktohen me statut dhe aktet e organit suprem drejtues ose vendimmarrës.

Për nevojat e biznesit dhe për të kryer veprimtarinë e saj, shoqata ka të drejtë të hapë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, qoftë shtetërore apo private.

Për nevojat e kësaj shoqate, ajo mund të punësojë persona të ndryshëm me grada akademike apo njerëz të thjeshtë me profesione të ndryshme, duke siguruar të gjitha të drejtat e punës që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar për marrëdhëniet e punës dhe kontratën.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi këshillues i Shoqatës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët në përputhje me pagesën e tarifës.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet një herë në vit për të miratuar buxhetin. Njoftimi për mbledhjen e Asamblese duhet të bëhet të paktën 30 ditë përpara datës së caktuar duke e dërguar me letër rekomande me dëftesë kihim pergjigje, e-mail, faks ose çdo mjet tjetër që vërteton marrjen e saj nga personi i duhur. Asambleja mund të mbledhet në selinë e Shoqatës, ose në çdo vend tjetër që Keshilli Drejtues e konsideron të përshtatshëm.

Njoftimi për mbledhjen e Asamblese përgatitet nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm dhe duhet të përmbajë shënimin e ditës, orës, vendit, çështjeve që do të diskutohen dhe shënimin e datës së thirrjes së dytë në rast se e para nuk arrin kuorumin e kërkuar. Anëtarët mund të dërgojnë propozimet e tyre, me email, të paktën 10 ditë përpara datës së takimit.

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Kryetari në një sesion të jashtëzakonshëm sa herë që Keshilli Drejtues e gjykon të arsyeshme ose me iniciativën e të paktën një të dhjetës së anëtarëve të zakonshëm dhe themelues, me anë të një kërkesë drejtuar Keshillit Drejtues, të paktën 30 ditë përpara datës së caktuar. Mbledhja zhvillohet në selinë e shoqatës ose në një vend tjetër të shënuar në njoftim. Thirrja bëhet me letër ose email të thjeshtë, të komunikuar të paktën 15 ditë përpara datës së caktuar për takimin. Rendi i ditës përcaktohet nga Keshilli Drejtues dhe duhet t'i bashkëngjitet njoftimit.

Vetëm anëtarët e pranuar në mbledhje dhe aktualisht të pranishëm mund të marrin pjesë në votim. Votimi me prokurë nuk lejohet. Nuk mund të merret asnjë vendim për çështje që nuk përfshihen në rendin e ditës bashkëlidhur mbledhjes.

Vendimet e Asamblese merren me shumicë të thjeshtë të të pranishmëve dhe me praninë e të paktën gjysmës plus një të anëtarëve të shoqatës. Në thirrjen e dytë, vendimet janë të vlefshme pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm.

Për të modifikuar Statutin dhe aktin nënligjor, kërkohet prania e të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtave) të anëtarëve dhe vota e favorshme e shumicës së të pranishmëve. Vendimet e asamblesë së përgjithshme regjistrohen në një regjistër të nënshkruar nga kryetari dhe sekretari i asamblesë, që ruhet në selinë e shoqatës ose në një vend tjetër të miratuar nga asambleja, ku është në dispozicion të anëtarëve.

Asambleja e Përgjithshme ka të gjitha kompetencat për realizimin e objektivave të shoqatës. Në veçanti, ajo vendos në lidhje me:

- ndryshimin e Aktit Themelues dhe Statutit të Shoqatës;
- përcaktimin e drejtimeve kryesore dhe parimeve udhëzuese, fushave të ndërhyrjes dhe programeve të veprimtarisë së Shoqatës të propozuara nga Keshilli Drejtues;
- raportet periodike të paraqitura nga Keshilli Drejtues në lidhje me zbatimin e programeve të sipërpërmendura dhe administrimin e pasurisë së Shoqatës;
- miratimin e pasqyrave financiare paraprake dhe përfundimtare të menaxhimit për çdo vit financiar;
- miratimin e rregulloreve të brendshme të Shoqatës;
- ratifikimin e vendimit të Keshillit Drejtues në lidhje me shumën e kuotës vjetore të anëtarësimit;
- zgjedhjen çdo pesë vjet të anëtarëve të Keshillit Drejtues, të përzgjedhur midis anëtarëve të Shoqatës që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Statut;
- vendimet mbi ankimet kundër vendimeve për përfundimin e statusit ose përjashtimin e anëtarit, të marra nga Keshilli Drejtues; Asambleja vendos brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit, ose brenda 60 ditëve në



A2025052640273750048

rast të ndërlíkueshmërisë së njoftimit, duke i komunikuar vendimin palës së interesuar brenda 15 ditëve pasardhëse dhe mund ta shprehë votën edhe me e-mail ose në mbledhje audiovizive. Vendimet janë të motivuara shkurtimisht, të paaportueshme, të miratuara me shumicë absolute dhe kanë fuqi detyruese;

- i) krijimin e komiteteve të posaçme dhe rregulloret e tyre;
- j) zgjedhjen e anëtarëve të Keshillit të Ndermjetesve;
- k) shpërndarjen e Shoqatës;
- l) delegimin e fuqive specifike të Keshilli Drejtues.

Neni 7

Organet e para ekzekutive

Këshilli Drejtues përbëhet nga anëtarët themelues, të cilët janë anëtarë pa kufizim mandati dhe maksimumi 11 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme. Këshilltarët qëndrojnë në detyrë për tre vjet dhe mund të rizgjedhen radhazi pa afat. Këshilltarët mund të japin dorëheqjen para përfundimit të mandatit të tyre duke i dërguar një letër të regjistruar ose email Kryetarit. Asambleja e Përgjithshme mund të revokojë mandatin e këshilltarëve, me propozim të Kryetarit dhe Kryetarit të Keshilli të Ndermjetesve, vetëm në rast të sjelljes së provuar në kundërshtim me interesat e Shoqatës. Asambleja diskuton me votim të fshehtë. Miratimi kërkon 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm. Këshilli drejtohet nga Kryetari i cili e thërret atë, me nismën e tij ose me kërkesën e të paktën 1/5 së anëtarëve të Keshillit ose 1/3 e anëtarëve të Asamblese, me njoftim të dërguar të paktën 15 ditë përpara. Takimet mund të mbahen edhe nëpërmjet lidhjes audiovizive telematike. Për vlefshmërinë e mbledhjeve kërkohet prania e 2/3 e anëtarëve në thirrjen e parë. Në thirrjen e dytë mbledhja është e vlefshme nëse marrin pjesë të paktën një e treta e anëtarëve. Rezolutat miratohen me shumicë të thjeshtë të të pranishmëve. Rezolutat u komunikohen anëtarëve të Shoqatës dhe mund të kundërshtohen, brenda 30 ditëve nga komunikimi, përpara Asamblesë së Përgjithshme. Këshilli mbledhet në mënyrë të vlefshme, edhe nëse nuk respektohen formalitetet e sipërpërmendura, nëse të gjithë këshilltarët janë të pranishëm ose të përfaqësuar njëkohësisht. Keshilli Drejtues ka të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të natyrshme për administrimin e Shoqatës që i përkasin qëllimit të korporatës, me përjashtim të asaj që me ligj ose me statut i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

Në veçanti, Këshilli Drejtues vendos për:

- propozimin në Asamblesë e Përgjithshme për çdo ndryshim statutor;
- përgatitjen e projektbuxhetit dhe pasqyrës financiare për t'i paraqitur Asamblese.
- propozimet në lidhje me drejtimitet e përgjithshme dhe udhëzimet kryesore të veprimtarisë së Shoqatës, t'i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme;
- raport periodik, të paktën një herë në vit, që do të paraqitet për miratim në Asamblesë e Përgjithshme lidhur me zbatimin e programeve të Shoqatës dhe disponimin e aseteve të saj;
- kriteret për administrimin e aseteve dhe çështje të tjera ekonomike dhe financiare që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqatës;
- pranimin e donacioneve
- hapja e zyrave dhe qendrave të reja në përputhje me politikën dhe misionin e Shoqatës;
- përcaktimin dhe ndryshimin e kuotës së anëtarësisë;
- delegimin e kompetencave një ose më shumë anëtarëve të Keshillit Drejtues;
- delegimin e kompetencave individuale dhe detyrave specifike të prokurorëve të tjerë specialë;
- vendimet kundër anëtarëve të propozuar nga Keshilli i Ndermjetesve
- çdo çështje tjetër që nuk i rezervohet me ligj ose statut kompetencës së Asamblesë dhe që ka të bëjë me zbatimin e qëllimit të shoqatës.

Këshilli i parë Drejtues, i cili do të jetë në detyrë për tre vjet, përbëhet nga:

1. Cristhian Armati
2. Marjus Çela
3. Susanna Ciacci
4. Elisabetta D'anella
5. Giuseppe Mazzei
6. Abramo Poggi
7. Klaudian Salliu



A2025052640272752048

8. Michele Sassanelli
9. Samuele Poggi

Z. Giuseppe Mazzei është zgjedhur në mandatin e parë si Kryetar dhe përfaqësues ligjor i Shoqatës.
Z. Marjus Çela është zgjedhur Nënkyetar i Parë.
Z. Klaudian Salliu është zgjedhur Nënkyetar.
Z. Susanna Ciacci është zgjedhur Sekretare e Përgjithshme.
Z. Cristhian Armati është zgjedhur Përgjegjesi i financave (Arketari)
Z. Abramo Poggi është zgjedhur Përgjegjës i Keshillit të Ndermjetesve.

Neni 8

Kompetencat e Kryetarit të Shoqatës

Kryetari është përfaqësuesi ligjor i Shoqatës dhe e përfaqëson atë përpara palëve të treta dhe në gjykatë. Ai ka të drejtën të nënshkruajë çdo akt që lidhet me administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm në emër të Shoqatës, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Kryetari zgjidhet nga Këshilli Drejtues mes anëtarëve të tij dhe mandati i tij është pesë vjet. Ai mund të rizgjidhet pa kufizime kohore. Në raste urgjente, Kryetari mund të marrë vendime dhe masa që i përkasin Këshillit Drejtues, por duhet t'i paraqesë për ratifikim në mbledhjen e radhës së Këshillit Drejtues. Kryetari gjithashtu emëron ose shkarkon përfaqësues të posaçëm të Shoqatës për çështje të veçanta ose për kategori aktesh. Kryetari drejton mbledhjet e Këshillit Drejtues, kontrollon vlefshmërinë e mbledhjeve dhe siguron që ato të zhvillohen në mënyrë të rregullt dhe të drejtë. Kryetari raporton çdo vit në Asamblenë e Përgjithshme për veprimtarinë e Këshillit Drejtues dhe për menaxhimin financiar të Shoqatës. Nëse për ndonjë arsye Kryetari largohet nga detyra, Këshilli Drejtues duhet të mblidhet brenda 30 ditëve, me kërkesë të të paktën dy anëtarëve të tij, për të emëruar Kryetarin e ri. Në rast të një pengese të përkohshme, Kryetari zëvendësohet nga Nënkyetari i Parë, i cili merr të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e tij.

Neni 9

Burimet financiare të Shoqatës

Burimet e financimit për funksionimin e vazhdueshëm të Shoqatës do të përbëhen nga fonde ose pasuri që do të sigurohen nga:

- donatorë vendas ose të huaj,
- individë,
- organizata,
- subjekte private ose publike, vendase ose të huaja,
- subjekte shtetërore,
- të ardhura që rrjedhin nga aktivitetet e vetë Shoqatës.

Burimet e të ardhurave të shoqatës janë anëtarësimet, fondet, grantet dhe donacionet e ofruara nga subjekte private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe të ardhurat nga aktiviteti ekonomik dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse.

Shoqata siguron të ardhura nga burime të njohura me ligj dhe kryen shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë për të cilën është krijuar, si dhe për administrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të saj.

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimeve ose përfitimeve financiare dhe materiale nga të ardhurat dhe fitimet e shoqatës në favor të personave që janë subjekt i statutit ose aktit të themelimit, me përjashtim të detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve dhe kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme ose për rimbursimin e shpenzimeve të shoqatës.

Shoqata, në raste të veçanta, mund t'u japë ndihmë financiare anëtarëve të saj, personave të jashtëm ose subjekteve të tjera. Shoqata mund të japë një ndihmë të tillë edhe nga fonde të dhuruara ose të vëna në dispozicion, në rastet kur donatorët e kanë përcaktuar shprehimisht këtë të drejtë.

Shoqata hap llogarinë e saj bankare pranë institucioneve bankare që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

Shoqata nuk pranon donacione apo financime nga burime kriminale dhe/ose të paligjshme dhe në rastet kur donacionet dhe financimet shoqërohen me kushte që do të kufizonin lirinë e vendimit apo veprimin të shoqatës. Mjetet dhe burimet financiare të shoqatës dhe të ardhurat nga veprimtaria e saj do të përdoren ekskluzivisht për qëllimin e veprimtarisë dhe qëllimin për të cilin është krijuar shoqata.



A2021651646172752048

Anëtarët nuk kanë të drejta mbi kapitalin e Shoqatës.

Nga buxheti i përgjithshëm i Shoqatës, fondet për zhvillimin e veprimtarive të miratuara ose për nevojat e tyre administrative kalojnë në degët kompetente në qarqe, në llogaritë bankare të hapura për këtë qëllim. Borxhet e Shoqatës paguhen vetëm me kapitalin e saj. Përfshihet çdo përgjegjësi personale e anëtarëve, përveç dëmeve të shkaktuara për fajin e tyre.

Neni 10

Ndalimi i shpërndarjes së fondeve

Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e Shoqatës do të përdoren ekskluzivisht për zhvillimin dhe zgjerimin e objektit të veprimtarisë së Shoqatës. Të ardhurat e tilla do të përdoren për qëllime statutores dhe për të mbuluar shpenzimet e bëra me kërkesë dhe në emër të Shoqatës.

Çdo veprim i kundërt është plotësisht i pavlefshëm dhe organet përgjegjëse do të mbajnë përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 11

Veprimtaria ekonomike

Shoqata duke u bazuar në ligj, ka të drejtë të ushtrojë veprimtari ekonomike, për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së saj.

Shoqata mund të zhvillojë veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e saj, të jetë deklaruar si një nga burimet e të ardhurave dhe me kusht që kjo veprimtari të mos përbëjë qëllimin primar të veprimtarisë së organizatës.

Nëse Shoqata, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, realizon fitime, ato duhet të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.

Neni 12

Shpërndarja me vendim të gjykatës

Gjykata mund të vendosë shpërndarjen e Shoqatës, me kërkesë të anëtarëve të saj, të organeve të saj vendimmarrëse, të organit shtetëror kompetent në rastet kur:

1. Veprimtaria e saj vjen në kundërshtim me Kushtetutën;
2. Kryen veprimtari të kundërligjshme;
3. Nuk është themeluar sipas kërkesave të ligjit;
4. Ka falimentuar sipas ligjit për falimentimin.

Përveç rasteve kur veprimtaria e Shoqatës përbën kërcënim serioz për publikun, gjykata duhet të lajmërojë me shkrim organizatën për shkeljen e ligjit dhe t'i japë asaj 30 ditë për të korrigjuar veprimtarinë e saj.

Neni 13

Likuidimi

Kur vendoset shpërbërja e Shoqatës, Këshilli Drejtues emëron një ose më shumë likuidues të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi pasurinë dhe përfaqësimin e Shoqatës nga data e emërimit të tyre deri në përfundimin e likuidimit.

Likuiduesit kryejnë veprimtarinë e tyre në bazë të nenit 47 të ligjit "Për organizatat jofitimprurëse" dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi. Me emërimin e likuidatorit ose likuiduesve, Kryetari nuk ka më asnjë funksion. Kur shpërndarja e Shoqatës vendoset vullnetarisht nga Këshilli Drejtues, ky organ kontrollon dhe miraton përfundimisht procedurat e likuidimit, miraton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me kërkesë për shpërndarjen e Shoqatës.



A2025652640272750048

Nëse raporti përfundimtar i likuiduesve nuk miratohet nga Këshilli Drejtues, ai shqyrtohet nga Gjykata në prani të palëve. Likuiduesi ose likuiduesit emëtohen me vendim të Këshillit Drejtues.

Neni 14 Çregjistrimi

Kur shpërndarja është vendosur nga Shoqata, organi kompetent, sipas statutit, miraton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe kërkon nga gjykata çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse.

Në rastet kur organi kompetent i Shoqërisë nuk miraton raportin përfundimtar të likuidatorit ose shpërndarjes dhe likuidimin e ka vendosur gjykata në seancën gjyqësore në prani të përfaqësuesve të organizatës jofitimprurëse dhe të likuidatorit, ajo shqyrton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe merr vendim për çregjistrimin e saj.

Neni 15 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë veprimtarisë së Shoqatës, palët do të përpqihen r'i zgjidhin ato në mënyrë konsensuale, në të kundërt gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Neni 16 Dispozitat Përfundimtare

1. Z. Giuseppe Mazzei është përgjegjës për kryerjen e të gjitha veprimeve të tjera dhe nxjertjen e të gjitha deklaratave të nevojshme ose të dobishme në lidhje me veprimet e mësipërme;

2. Të kryejë procedurat e regjistrimit të shoqatës në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse dhe në të gjitha autoritetet e tjera.

Z. Giuseppe Mazzei, ka të drejtë të autorizojë me prokurë të posaçme një avokat ose një studio ligjore të zgjedhur prej tij, duke i dhënë avokatit ose studios ligjore të drejtën për të nënshkruar, depozituar, përfaqësuar kërkesën për regjistrimin e shoqatës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe të përcaktojë në mënyrë të pavarur vlerën e dëmshpërblimit për avokatin ose studion ligjore.

Ky akt themelimi është hartuar në pesë kopje, me vlerë juridike të barabartë dhe u lexua në prezencë të perkthyeses së licencuar nga Ministria e Drejtësisë, të gjuhës italiane Jonida Ohri dhe u nënshkrua rregullisht përpara meje Noteres nga palet.

Në zbatim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë, Noteri, deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti në mënyrë korrekte dhe të ligjshme.

Unë, Noteri, kam verifikuar identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi konstatova përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm në përputhje të plotë me nenet 62, 63 e në vijim të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterët", vërtetoj nënshkrimet e tyre. Në zbatim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë, Noteri, deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate në mënyrë korrekte dhe të ligjshme.

THEMELUESIT:

Cristhian Armati

CRISTHIAN ARMATI

Marjus Çela

MARJUS ÇELA



A202103264027202048

Susanna Ciacci

SUSANNA CIACCI
Susanna Ciacci

Elisabetta D'anella

Elisabetta D'Anella

Giuseppe Mazzei

GIUSEPPE MAZZEI
Giuseppe Mazzei

Abramo Poggi

ABRAMO POGGI
Abramo Poggi

Klaudian Salliu

Klaudian Salliu
Klaudian Salliu

Michele Sassanelli

MICHELE SASSANELLI
Michele Sassanelli

Samuele Poggi

SAMUELE POGGI
Samuele Poggi

PREZENTE

Perkthyses Jonida Ohri

Jonida Ohri
PERKITHYES ZYRTARE GJITHES
JONIDA OHRI
CERTIFIKATE
NR.502
ITALIANE

NOTERE
PERIAN BODINAKU

[Signature]

ATTO COSTITUTIVO
dell'Associazione "FAMILJA ITALBA"

Oggi, il 02/04/2025, davanti a me il Notaio PERIAN B. BODINAKU, membro della Camera Nazionale del Notaio, Sezione Locale di TIRANA, con studio a Tirana, Ç. TOPULLI, soci fondatori dell'Associazione "Famiglia Italba", sono stati personalmente presentati,

1. **Cristhian Armati**, atësia Emilio, amësia Maria Isabella Ruggieri, lindur më 29.01.1985 në Trescore Balneario (BG), Itali, banues në Durrës, Rr. Taulantia, 00690806, Nd. 13, H. 1, Durrës, i identifikuar me letërnjoftimin nr. AY1542996 dhe lejen e qëndrimit nr. I53129002W.
2. **Marjus Çela**, atësia Ilirjan, amësia Lindita, lindur më 25.09.1984 në Durrës, banues në Durrës, i identifikuar me letërnjoftimin nr. I40925075A.
3. **Susanna Ciacci**, atësia Renato, amësia Giovanna, lindur më 02.08.1957 në Romë, Itali, banuese në Durrës, Rr. Taulantia, 00690806, Nd. 1/1, H. 1, Durrës, e identifikuar me letërnjoftimin italiane nr. CA53392RD dhe me leje qëndrimi nr. F78802002J.
4. **Elisabetta D'anella**, atësia Pietro, amësia Enda, lindur më 20.10.1972 në Itali, banuese në Rr. Perlat Rexhepi, Nd. 8, H. 6, Ap. 2, Njësia administrative nr. 5, Tiranë, e identifikuar me pasaporte nr. YB8020369 dhe lejen e qëndrimit nr. H29020003N.
5. **Giuseppe Mazzei**, atësia Vincenzo, amësia Carmela, lindur më 07.01.1953 në Rotondella, Itali, banues në Durrës, Rr. Egnatia, 00690218, Nd. 54, H. 1, Durrës, i identifikuar me letërnjoftimin italiane nr. CA59468IH dhe me leje qëndrimi nr. F33107003H
6. **Abramo Poggi**, atësia Bruno, amësia Sartori Rosa Pia, lindur më 27.07.1967 në Gazzola, Itali, banues në Durrës, Hani i Kthupit 00690312 Nd 5, 2003 Durrës, i identifikuar me lejen e qëndrimit nr. G73727002H.
7. **Klaudian Salliu**, atësia Ismail, amësia Aferdita, lindur më 14.10.1985 në Peshkopi, i identifikuar me letërnjoftimin nr. I51014051N.
8. **Michele Sassanelli**, atësia Giacomo, amësia Brandonisio Santa, lindur më 30.08.1983 në Bari, Itali, i identifikuar me letërnjoftimin italian nr. CA59537DG dhe lejen e qëndrimit nr. I33830002A.
9. **Samuele Poggi**, atësia Abramo, amësia Stefania Bosini, lindur më 23.05.2001 në Piacenza, Itali, banues në Via Roma, Nr. 145, Gazzola, Itali, i identifikuar me letërnjoftimin italiane nr. CA26673PC dhe lejen e qëndrimit nr. K13523005D

Tutti pienamente capaci di agire legalmente, e basandosi sulla Legge n. 8788 del 07.05.2001 "Sulle Organizzazioni Non Profit" e sulla Legge 80/2021 "Sulla registrazione delle organizzazioni non profit", e sugli articoli 39 e seguenti del Codice Civile, hanno fondato l'organizzazione non profit, l'Associazione "Famiglia Italba".



Articolo 1

Status giuridico dell'associazione

L'Associazione "Familja Italba" è stata fondata liberamente da un gruppo di membri ed è un'associazione non profit con adesione. È un'organizzazione non governativa, indipendente dai partiti e dalle organizzazioni politiche, e gode di libertà e autonomia d'azione in conformità con la legislazione vigente, lo Statuto e il suo Programma.

Articolo 2

Denominazione dell'associazione

L'associazione si chiama "Familja Italba" e opera in conformità con la Legge n. 8788 del 07.05.2001 "Sulle Organizzazioni Non Profit". L'associazione ha il suo stemma (logo) e timbro. La forma e il contenuto dello stemma (logo) e del timbro dell'associazione sono determinati dagli organi direttivi dell'associazione. Il logo dell'associazione sarà: Bandiera tricolore italiana verde, bianco e rosso con aquila bicefala sulla striscia di colore rosso.

Articolo 3

Inizio delle attività, Sede, Durata

L'associazione acquisisce personalità giuridica dalla data di registrazione nel Registro delle organizzazioni non profit presso il Tribunale di Primo Grado di Giurisdizione Generale di Tirana.

L'associazione ha la sede centrale a Durazzo, all'indirizzo: Rruga A.Goga, lagjja 11, ZK 8514, Pasuria 1/X-ND1-3, Durres.

